

# republika e shqipërisë KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr.  $\frac{940}{7}$  Prot

Fier më, 30101/2025

### PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 30.01.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:00. Të pranishëm në mbledhje 38 këshilltarë.

Znj.Antoneta Çunaj

Përshëndetje të gjithëve! Jemi gati sekretar për të filluar zhvillimin e mbledhjes në bazë të firmave që u mblodhën ?

### Z.Arnando Çupa

Përshëndetje të gjithëve! Në bazë të firmave që u mblodhën, kuorumi është plotësuar dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen e këshillit.

Znj.Antoneta Çunaj

Po, faleminderit! Rendi i ditës ju ka ardhur më parë në mënyrë elektronike. Përveç rendit të ditës që ju është bërë me dije nga mbledhja e kryesisë, kanë ardhur edhe disa pika shtesë për të cilat ju janë dërguar elektronikisht edhe materialet. Edhe njoftimet për këto pika shtesë dhe konkretisht :

### Pika e parë shtesë

Projekt vendim "Për miratimin e përfundimit të proçedurave të privatizimit të banesës e cila ka mbetur pa u regjistuar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratës para noterit"

# Pika e dytë shtesë

Projekt vendim "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 130 datë 26.11.2024 "Për miratimin e financimit të shpenzimeve të transportit të nxënësve që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër në një largësi mbi 2km larg institucioneve arsimore publike më të afërta"

# Pika e tretë shtesë

Projekt vendim "Për miratimin e vendndodhjes së projektit "Dua të luaj" **Pika e katërt shtesë** 

Projekt vendim "Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese nga projekti për strehimin social"

#### Z.Kreshnik Dapi

Së pari:Më bën çudi të madhe dhe këtu vlen ajo fjala:Çorganizim i organizuar.E fillojmë me mbledhjen tonë të kryesisë.Kemi bërë një mbledhje kryesie, herën e fundit, në shkelje të rregullores. E kemi bërë në datën 22 janar, ndërkohë që rregullorja thotë që duhet të jetë 10 ditë përpara ditës së mbledhjes së këshillit.E dyta.I drejtohem administratës së bashkisë, mqs kemi këtu edhe kryetarin, mos të sjellin më relacione dhe asnjë lloj dokumentacioni për këshillin dhe për këshilltarët, të pafirmosur dhe cikluar nga personat që e kanë punuar dokumentacionin përkatës.E treta.Sekrati i këshillit të mos hedhi më pika shtesë pa miratimin e kryesisë dhe jashtë afateve kohore.Tani unë nuk e kuptoj, në rendin që ne miratuam në mbledhjen e kryesisë, kishte 18 pika mdërkohë që rregullorja parashikon deri në 15 pika. Tani na vijnë deri pak para mbledhjes, dhe pika e katërt shtesë.Këto pika shtesë kush i ka studiuar nga këshilltarët sepse unë nuk kam arritur ti studiojë.E pashë pak përciptas pikën shtesë të rendit të ditës por nuk arrita sepse ishin shumë materiale shtesë për këtë pikë shtesë dhe koha ishte e pamjaftueshme.

#### Znj.Antoneta Çunaj

Konkretisht, për kë pikë shtesë e ke fjalën?

#### Z.Kreshnik Dapi

Për të katërta pikat shtesë e kam fjalën.Për mua kjo është papërgjegjshmëri nga administrata për qytetarët, se duket këtu tani se ne nuk duam të qëndrojmë apo të punojmë për të miratuar këto pika.Unë dhe grupi im, kemi një mendim dhe një propozim:Nqs rendi i ditës është kaq i ngjeshur dhe kjo bashki paska kaq shumë punë për tu shërbyer qytetarëve, ne të mblidhemi javë për javë, nqs duhet, dhe në orën 8 të mëngjesit dhe jo në orën 1,2,3,4,5 mbasdite sepse gjysma thonë të ngremë dorën se mos vonohemi dhe të ikim me vrapë.Mqs kjo pika e fundit shtesë, që ta mbyll, që të mos ju lodh, dhe mqs kjo duhet sepse është një gjë shumë e rëndësishme, atëherë unë propozoj që tek pika e tretë e rendit të ditës ku ne kemi betimin e këshilltares sonë, të zvd me pikën 22 ose pikën e katërt shtesë në rendin e ditës.

#### Znj.Antoneta Çunaj

Ka një procedurë dhe ju e dini fare mirë rregulloren.Do tju jepet e drjta e fjalës për çdo projektvendim, secilit këshilltarë, kushdo që e kërkon fjalën për pikat e rendit të ditës. Për pretendime apo për kërkesa apo për problematika jashtë rendit të ditës, çdo këshilltarë është i mirëpritur të flasi në fund fare në pikën që quhet diskutime sepse gjatë miratimit të pikave të rendit të ditës, do tu jepet leja vetëm këshilltarëve që do të flasin dhe do të diskutojmë për projekt vendimet apo pikat e rendit të ditës, ndryshe do ti ndërpritet e drejta e fjalës nga ana ime.Dhe e dyta që është më kryesorja, këto diskutime jashtë rendit të ditës nuk do të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes së këshillit.Pasi edhe prefektura na ka tërhequr vëmendjen që asnjë gjë jashtë rendit të ditës nuk duhet të futet në procesverbalin e mbledhjes.Pra edhe nqs ndonjë nga ju , këshilltarë të nderuar do të dojë të shkeli rregulloren dhe të mos jetë dakort me mua, ta keni të qartë që asnjë gjë nuk do të shënohet në procesverbal, edhe unë do ti heqë të drejtën e fjalës.

Z.Kreshnik Dapi

1

Çdo fjalë që thotë këshilltari duhet të hidhet në letër dhe i bëj thirrje çdo organi ligjzbatues që do ti bjeri në dorë dhe do të lexojë procesverbalin e çdo mbledhje të këshilli bashkiak Fier, ta lexojë me vëmendje dhe me kujdes të veçantë, sidomos ato mbledhje ku futen pika shtesë në mënyrë abuzive.

### Znj.Antoneta Çunaj

Unë u shpreha që nuk do të lejoj asnjë këshilltarë të flasi jashtë rendit të ditës pa përfunduar rendi i ditës.

### Z.Armando Subashi

Mqs jemi në rendin e ditës, unë kam edhe një propozim tjetër përveç katër pikave që u propozuan, kam edhe një pikë të pestë që të shtohet këtu dhe kërkoj mirëkuptimin dhe miratimin nga ana e këshillit.Bëhet fjalë për një kërkesë që ka ardhur dje, nga dy shoqatat e gazetarëve që kemi këtu, unioni i gazetarëve Shqipëtarë dhe shoqata e gazetarëve profesionist dhe bëhet fjalë që këshilli të miratojë një ndihmë të menjëherëshme, në masën 200 mijë lekë të reja, aq sa e kemi patur ne praktikën tonë, për gazetarin Gledian Hoxhallarin, pra bëhet fjalë për gazetarin i cili është duke luftuar me jetën për shkak të një incidenti që ka patur.Ai është shtruar në spital, është në jë gjendje kritike , kërkohet një ndërhyrje e specializuar.Ajo ndërhyrje kushton, sipas dokumentve që kemi këtu, pra dy kërkesave që kanë ardhur dhe propozoj që ne si bashki dhe këshill bashkiak të bëjmë pjesën tonë, pjesën tjetër pastaj ata mund ta vlerësojnë në drejtime të tjera për të marrë atë ndihmë që i takon.

### Znj.Evisa Sema

Të lutem kryetare, hidhe në votim rendin e ditës.

### Z.Yllka Sheshi

Më falni zonja kryetare, doja të shtoja dhe unë diçka.Përpara një jave ose 10 ditësh, kam sjellë një kërkesë në bashki, për një fëmijë 13 vjeçarë që u diagnostikua me sëmundje të keqe dhe pashë një sensibilizim shumë të lartë nga qytetaria Fierake, dhe jo vetën nga këta por nga mbarë gjithë Shqipëria.Nuk e shikoj këtë kërkesë në rendin e ditës.

Z.Armando Subashi Kush është ai fëmijë? Z.Yllka Sheshi Ai fëmijë është Noel Curra Z.Armando Subashi Ka ardhur kërkesa tek ne? Znj.Yllka Sheshi Po.

# Znj.Antoneta Çunaj

Ne këtë kërkesë e kemi diskutuar në mbledhjen e kryesisë dhe kemi kërkuar që të na vijë materiali plotësues dhe në parim jemi shprehur dakort.Dhe i kemi kërkuar këto materiale Z.Arben Çukos mqs kërkesa është bërë nga ana e grupit tuaj dhe ai na tha që do të përpiqej ti vinte në dispozicion sa më shpejt të mundej dhe sapo të na vinin materialet ne absolutisht jemi dashamirës për çdo njëri që është në nevojë por na duhen dokumentat.

# Z.Armando Subashi

Kryetare, unë kam këtë propozim.Pa diskutim që të shtohet dhe kjo tek rendi i ditës, ta marrim vendimin në parim sepse këshilli është ai që vendos dhe në momentin që vendimi do të zbardhet dhe do të bëhet efektiv dhe ato fonde të xhirohen,sigurisht që nga ana e zyrave të bashkisë, financës, shrbimit social etje të kërkohet dokumentacioni i duhur. Edhe për këtë rast që ju thashë, sigurisht nuk mjaftojnë vetëm këto dy kërkesa që kanë ardhur nga shoqatat, sepse ne të paktën do të kërkojmë një raport mjeksor nga sipatali ku ai ndodhet, dhe ato do të rrinë në dosje dhe pastaj do të bëhet xhirimi i lekëve.

Znj.Antoneta Çunaj

Si e ka emrin djali?

Znj.Yllka Sheshi

Ai djalë e ka emrin Noel Curra

# Z.Armando Subashi

Në rregull.Unë jam plotësisht dakort të futet dhe kjo kërkesë dhe ta miratojmë.

# Znj.Antoneta Çunaj

Kur janë ndihma, disa gjëra elementare duhen, mgjth le ta verifikojë financa.Ne e miratojmë në parim, ashtu si tha dhe kryetari.

# Z.Endri Jaupaj

Në lidhje me transmetimin live, kemi ndonjë pengesë?Jemi duke e transmetuar live këtë mbledhje?

Znj.Evisa Sema

Ju lutem kryetare, hidhe në votim rendin e ditës së bashku me shtesat dhe le të vazhdojmë mbledhjen sipas procedurës.

# Z.Endri Jaupaj

Të lutem mos më ndërhy, se jam duke folur.Lexo rregulloren.Përfaqësuesit e opozitës kanë të drejtën e fjalës dhe e marrin atë sa herë lidhet me shkeljen e procedurës.

# Znj.Antoneta Çunaj

Vazhdojmë me rendin e ditës së bashku me shtesat.

#### Z.Endri Jaupaj

Mos e anashkalo pyetjen dhe jep dorëheqjen lëre këtë këshill që të funksionojë normalisht se e ke marrë peng.

### Pika e parë e rendit të ditës

Miratimi i Rendit të Ditës

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakort për miratimin e rendit të ditës së bashku me gjashtë pikat shtesë.Duke futur dy rastet e menjëherëshme të ndihmës financiare, për gazetarin Gentian Hoxhallari dhe për djalin Noel Curra?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Z.Kreshnik Dapi

Zonja kryetare, si rasti i djaloshit dhe i gazetarit, që ta kuptojmë, tek pjesa e debatit që bëra unë, këto janë papërjashtim që të vijnë në çdo radhë dhe vota jonë është pro.Tek pjesa që tha kolegu për transmetimin live, është për të ardhur keq dhe është turp.Është për të ardhur keq ndërsa Evisa kërkon vazhdimin e mbledhjes që ne nuk jemi transparent me qytetarët dhe me veten tonë.

#### Pika e dytë e rendit të ditës

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 23.12.2024

Znj.Antoneta Çunaj

Vazhdojmë me pikë e dytë të rendit të ditës.Ky procesverbal është nëshkruar nga të gjithë përfaqësuesit e grupeve të këshilltarëve.

Z.Arnando Çupa

Kryetare, procesverbali është nëshkruar dhe u është dërguar me email të gjithë kryetarëve të grupeve të këshilltarëve.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakort?

Pro 36 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet

### Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Fier "

Znj.Antoneta Çunaj

I japim fjalën kryetarit të komisionit të mandateve.

# Z.Melsi Bogdani

Kryetare, nuk po e lexoj të gjithë raportin sepse jeni njohur nëpërmjet komunikimit elektronik. Me shkresën nr. 11800 prot, datë 12.11.2024, Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancave nga këshilltari Z. Ymer Riza Goga, propozuar nga subjekti politik "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë"

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me Vendimin nr.5 datë 08.01.2025, ka vendosur plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidaten nga lista shumemërore të subjektit politik "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë", Zj. Alesia Rapi Koroveshi.

Komisioni i Mandateve konstaton, se kandidatja për këshilltare Zj. Alesia Rapi Koroveshi, nuk është në kushtet e papajtueshmerisë, sipas përcaktimit të nenit 47 të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*".

Për sa më sipër, Komisioni i Mandateve vendosi të vërtetojë vlefshmërinë e mandatit të përfaqësueses së subjektit politik "Partia Socialdemokrate e Shqipërisë" Zj. Alesia Rapi Koroveshi.

Komisioni i Mandateve, pas miratimit të këtij raporti, i kërkon Kryetarit të Këshillit Bashkiak Fier, të ftojë Zj. Alesia Koroveshi, bazuar në nenin 50 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", të kryejë Betimin Solemn sipas Formulës së Betimit të përcaktuar në këtë nen, dhe të nënshkruajë Aktin e Betimit.

# Znj.Antoneta Çunaj

Hedhim në votim raportin e komisionit të mandatve përpara se të kryejë betim këshilltrja e re. Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka

Abstenim nuk ka

Miratohet

Znj. Alesia Koroveshi, e keni kartën e identitetit me vete?

Znj.Alesia Koroveshi

Po.

Znj.Antoneta Çunaj

Zonja Koroveshi është e pranishme, me document identifikim, kartë identiteti dhe përpara se të bëhet pjesë e këtij këshilli, në bazë të ligjit, unë do të lexoj formulën e betimit dhe ju në fund do të thoni betohem dhe më pas do ta nënshruani formulën e betimit.Pas këtij momenti, ju bëheni anëtare e këshillit bashkiak e subjektit që ju ka propozuar. "Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Fier dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre"

Znj.Alesia Koroveshi

Betohem

Znj.Antoneta Çunaj

Urime dhe faleminderit.

# Pika e katërt e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2025 "

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën?

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare, urime për futjen e planit vjetor në rendin e ditës.Më në fund, duke mbushur dalëngadalë vitin e dytë të mandateve, këshilli bashkiak Fier, më në fund ka një plan pune, por që nuk është akoma atje ku duhet të jetë, për hirë të së vërtetës, sepse përveç këtij plani të miratojmë dhe rregulloren e konsultimeve publike dhe rregulloren e ankimimeve sipas modeleve të ofruara nga projekti "Bashki të forta"Gjithësesi dita e sotme është për tu shënua, dhe urime.

# Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit!Diskutime të tjera ka?Nuk ka, e hedhim në votim.

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e pestë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin dhjetor 2024"

Znj.Antoneta Çunaj

I japim fjalën përfaqësueses së bashkisë.

Znj.Merita Bitri

Për muajin dhjetor, do të kalojnë gjithësej 47 familje, ku 6 familje do të hiqen nga skema për arsyen se do të aplikojnë në sistem dhe futen 4 familje të cilat sipas administratorëvë social të njësive janë në gjendje të vështirë ekonomike.Fondi i këtij muaji në total është 214,587 (dyqind e katermbedhjetemije e peseqind e tetedhjete e shtate) lekë

Znj.Antoneta Çunaj

E do ndonjëri fjalën?

Z.Elvi Daka

Faleminderit për fjalën!Duke vlerësuar të gjitha materialet që ju vunë në dispozicion Komisionit të Mirëqënies Sociale, ditën e djeshme është mbajtur mbledhja e komisionit.Unë dhe të gjithë anëtarët e këtij komisioni nga maxhoranca ishin prezencë, ndërsa kishim mungesë nga pjesa tjetër e përfaqësimit.U panë dhe u vlerësuan të gjitha raportet sociale të sjella në komision për katër rastet e reja, që do të hyjnë në skemën 6%, dhe u vlerësu si një dokumentacion i rregullt për ti kaluar këshillit për miratim.Gjithashtu gjej momentin për të kërkuar një zëvëndësim në Komisionin e Mirëqënies Sociale të anëtares së ndjerë Znj.Mirela Levanai e cila ka qënë pjesë e këtij komisioni.

Znj.Antoneta Çunaj

E do ndonjëri tjetër fjalën?Po, inxhinier.

Z.Ilia Fili

Në materialin që përgatitur zonja Bitri, thuhet që janë katër gra ato që shtohen në skemën e 6%.Pyes janë kryefamiljare këto katër gra?

Znj.Merita Bitri

Nuk janë katër gra, por janë tre gra dhe një burrë dhe janë kryefamiljarë.

Znj.Antoneta Çunaj

Mqs pyetje të tjera ska, e hedhim në votim

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

### Pika e gjashtë e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmën ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e Pushtetit Qëndror e Vendor për vitin 2025"

# Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht le të flasi përfaqësuesi i bashkisë .

# Znj.Merita Bitri

Mqs ligji e përcakton të detyrueshëm çdo fillim viti buxhetor kalimin në këshillin bashkiak të kritereve të familjeve në nevojë që të trajtohen me ndihmë ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar, ne jemi të detyruara që të paraqesim këtë projekt vendim para këshillit bashkiak për miratimin e këtyre kritereve.Në rastin konkret e kemi përcaktuar që kriteret e këtij viti do të jenë të pandryshuara nga ato të vitit të mëparshëm.Pra nuk do të kemi ndonjë ndryshim të vitit të mëparshëm të cilat janë miratuar me vendimin nr.2 të 30.01.2024 të këshillit bashkiak.

# Znj.Antoneta Çunaj

Po i japim fjalën përfaqësuesit të komisionit.

# Z.Elvi Daka

Duke qënë se dhe kjo pikë e rendit të ditës është pjesë e trajtimit të Komisionit të Mirëqnies Sociale, duke e vlerësuar pak edhe mënyrën se si është prioritizuar dhënia e këtij shërbimi të 6% te kategoritë që përfshihen.Kështu janë përfshirë familje me të ardhura të pamjaftueshme, gratë kryefamiljare të vetme, të divorcuara në moshë të madhe, të veja me fëmijë të mitur, jetim, kryefamiljarë PAK ose anëtarë të tillë që nuk marrin pagesë paaftësie.Ne kemi vlerësuar që këto janë grupe le të themi më të disavantazhuara apo ato që kanë nevojë më shumë për përkrahje dhe për të hyrë te ky fondi 6% dhe është vlerësuar që ky dokument do të paraqitej pa ndrysh edhe në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe më pas për konfirmim në Prefekturë.Faleminderit!

# Znj.Antoneta Çunaj

E do fjalën ndonjë anëtar këshilli?Mqs nuk ka pyetje e hedhim në votim.

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

### Pika e shtatë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier të shtetasit Theodhor Haki Bejko" Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë njëri për të diskutuar apo ta hedh direct në votim.Nuk ka diskutime.

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

### Pika e tetë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për një shtesë nga të ardhurat e trasheguara në buxhetin e Bashkise Fier per vitin 2025"

# Znj.Antoneta Çunaj

Po i japim fjalën përfaqësuesit të komisionit.

Znj.Pranvera Cina

Nga rakordimi që kemi bërë me degën e thesarit në Fier, kemi trashëguar nga viti 2024 pë vitin 2025 shumën 409,866,747 lekë. Duke qene se me vendimin nr 139 Dt 23.12.2024 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2025-2027), dhe miratimin e Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025", ne shtuam dhe shperndame sipas programeve vleren prej 150,000,000 leke dhe mbetet per tu shtuar ne Buxhetin e Bashkise Fier per vitin 2025 vlera e mbetur prej 259,866,474 leke .Kjo vlere do shperndare ne baze te kerkesave buxhetore ndermjet programeve .

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë njëri që kërkon fjalën?Po Z.Kreshnik Dapi

# Z.Kreshnik Dapi

Ne si grup jemi kundra kësaj pike dhe nuk e kuptoj se këtu është kthyer në fenomen mungesa e transparencës nga ana e administratës së bashkisë për këshillin.Vjen dhe zonja tani, drejtoresha, me një relacion të thatë fare që na është shpërndarë edhe ai me vonesë dhe nuk shpjegon asgjë.Unë edhe në mbledhjen e dhjetorit për buxhetin e vura në dukje këtë shipër 250 milon lekë të reja të trashëguara nga viti I kaluar.Tani këtë punë nuk e kuptoj,Pse nuk sillni ju një relacion të detajuar, analitik, sepse atë ditë kryetari e tha me fjalë që kjo shifër del si rezultat I kursimit në thonjëza, tek-tuk tek ndonjë project apo bërje investimi, dhe tek mosrealizimi I disa investimev gjatë një viti.Pikërisht kjo ka nevojë për një analizë të detajuar që këshilli të jetë I qartë se çfarë ka ngelur pa bërë nga viti 2024 që po trashëgohet në vitin 2025 sepse nuk është një fjalë goje, sepse ajo që ka ngelur pa bërë dthm një mungesë investimi apo një mungesë shërbimi ndaj komunitetit ose një problematikë tjetër që ka nevojë për veprime të tjera mbështetëse.E dyta.Këto katër ndërrmarje të pamshme që shikoj këtu unë, që kanë bërë menjëherë kërkesë për të tërhequr lekë , pra fonde nga këto të trashëguara.Këto kishin, me çfarë pashë tek buxheti, kishin llogaritur atje fonde.Kur I kanë shpenzuar ato fonde që tani pa u mbyllur muaji janar dhe pa filluar mirë lëvrimi I buxhetit të ri, këto na kërkokan fonde akoma shtesë nga këto të trashëguara.Kjo nuk lë përshtypje të mirë.

# Znj.Pranvera Cina

Sepse në buxhetin fillestarë është bërë miratimi në bazë të tavaneve dhe ndërrmarjet kanë paraqitur edhe kërkesa shtesë.

# Z.Kreshnik Dapi

Mua më duket shumë e parakohëshme kërkesa e ndërrmarjeve dhe shumë abusive dhe kërkesat e ndërrmarjeve, po ti shikosh, ato janë skandaloze sepse aty shikohet që nga këto 250 milion lekë të reja, nga të cilat thuhet nga ju 1.4 miliard lekë të vjetra në mos gaboj, vijnë nga mosbërja e investimeve, apo jo nga 2024 sa është ajo shifër? Pak rëndësi ka kushdo shifër. Këta zotërinj tani këto lekë I kërkojnë për antiviruse, për gëlqere, për bojë printer ... nuk më duket normale me thënë të drejtën kjo gjë.Plus edhe këtë që kërkojnë nuk e kanë të detajuar.Thjeshtë kanë sjellë një kërkesë A4 aty, me firmë dhe vulë dhe kërkojë milona e miliona lekë nga këshilli.Jo ne me këtë nuk jemi dakortë dhe kjo nuk duket një praktikë e ndershme.

# Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë tjetër këshilltarë që do fjalën?Po inxhinier

# Z.Ilia Fili

Unë e pashë me vëmendje të tërë materialin dhe bashkohem me vrejtjet e parafolësit, por më bënë përshtypje që gjithë ky buxhet që po trashëgojmë nga viti I kaluar, ndahet në dy zëra shpenzimet operative që janë goxha dhe investimet që janë të ulëta.Unë do tu sygjeroja që një pjesë nga shpenzimet e parashikuara për shpenzime operative, të kalojnë tek fondi rezervë.Bashkia të mos gjendet e papregatitur në rast emergjencash.

# Z.Armando Subashi

I kemi ato rezerva të flanifikuara, I kemi në masën 4% .Ajo është me ligj, atje nuk lëvizim dot asgjë dhe pot ë duam.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë tjetër këshilltarë që do fjalën? E hedhim në votim

Pro 35 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

# Pika e nëntë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë"

Znj.Antoneta Çunaj

Po i japim fjalën përfaqësueses së administratës.

Z.Ilia Fili

Pa folur zonja, në mos gabohem, ne kemi miratuar këtu në këshill vlerat që mbulon bashkia për qeratë e shtëpibe që arrin familjet në tregun e lirë.Pra vlerat ne i kemi përcaktuar, tani na vjen material ku na kërkohet rishikim i këtyre vlerave.Duket sikur luajmë me vendimet që marrim këtu

Z.Armando Subashi

Kush e ka bërë këtë material?

Z.Arnando Çupa

Këtë material e ka pregatitur Komisioni i Strhimit.

Z.Armando Subashi

Në rregull atëherë.Le të flasi përfaqësuesi i Komisionit të Strehimit

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni për këtë projekt vendim?

Znj.Denisa Azizaj

Komisioni është mbledhur. Të gjithë anëtarët kanë qënë të pranishëm, kanë rënë dakortë dhe kanë miratuar listën e familjeve që do të përfitojnë bonusin e qerasë dhe jo vlerën.

Z.Ilia Fili

Mua më shqetëson fakti që ne i kemi miratuar vlerat sipas zonave për qeratë e këtyre familjeve, dhe tani po del që ne po shtojmë fonde mbi ato që kemi miratuar.E kuptoni që këtu ka një ngërç?

### Z.Armando Subashi

Nuk ndryshojnë vlerat inxhinier.Vlerat janë ato që janë.Komisioni sjellë listën tani me 10 familjet që përfitojnë.

### Z.Kreshnik Dapi

Me cilësinë e nënkryetarit të Komisionit të Strehimit, komisioni është mbledhur për të dyja pikat e rendit të ditës, si për pikën në fjalë dhe për pikën pasardhëse.Dokumentacioni ka qënë i plotë.Vendimarrja ka qënë unanime dhe unë propozoj që ta hedhim në votim.

### Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim pikën nëntë të rendit të ditës

Pro 38 vota

Kundra nuk ka..

Abstenim nuk ka.

Miratohet

# Pika e dhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit "Subvencionimi i interesave të kredisë' për vitin 2025."

# Znj.Antoneta Çunaj

Përfaqësuesi i komisionit sapo tha që është mbledhur komisioni, nuk ka patur kundërshtime, kanë qënë të gjithë pro.A ka ndonjëri për të diskutuar?Nuk ka.E hedhim në votim

Pro 38 vota

Kundra nuk ka..

Abstenim nuk ka.

Miratohet

### Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës

Projrkt vendim "Per miratimin e projektit "Rikonstruksion I rrugës qëndër Darëzezë deri në bregdet"

Znj.Antoneta Çunaj

Le të flasi fillimisht përfaqësuesi I administratës që ka hartuar project vendimin, pastaj përfaqësuesi I komisionit të këshillit bashkiak dhe me radhë këshilltarët. Z.Endri Jaupaj Unë e kam parë këtë project, është mbledhur komisioni dhe e kemi diskutuar.Unë kisha një pretendim që mund të bëhej më mirë ky project.Mund të bëhej me trotuar, me ndriçim, një rrugë për biçikletat pasi është një nga pikat më të bukura, që edhe kryetari vit për vitë e promovon si pikë turistike.Ajo gjerësia e rrugës që është parashikuar është e mjaftueshme por vetëm 6 m e gjerë dhe rrugë vetëm për makina.Mbase bëhët më vonë ndonjë projek shtesë, porn ë parim jam dakort, mbase duhet të ishte bërë më përpara por gjithësesi është ok. Znj.Antoneta Çunaj

Çdo gjë bëhet aq sa fonde kemi.Sot për sot e kemi filluar dhe shyqyrë që filloi një diçka e re.Të tërë ne si anëtarë këshilli jemi të bëhet më e mira.Të fillojmë tek e mira dhe ta çojmë tek shumë e mira.

### Z.Armando Subashi

Sigurisht që ne kemi qënë pak të limituar, pra duke mos vënë këto elemente që ju thatë,duke patur parasysh buxhetin në radhë të parë që ka qarku.Sepse ashtu si dhe sshikohet këtu, ne kemi një marrëveshje paraprake me këshillin e Qarkut të Fierit, që ndoshta mund të financojë pjesën dërrmuese të projektit.Vlera e saktë e financimit të Qarkut do të dali mbasi edhe ata të mbyllin pjesën se sa do të mbartin nga viti I kaluar, dhe pjesën tjetër do ta financojmë ne si bashki.jam dakort dhe jemi të hapur që në varësi të vlerës mundet të shtojmë edhe ndriçimin , pasi ndriçimi nuk është ndonjë vlerë konsiderueshme,Pastaj pjesa e trotuarit mund ta shikojmë qoftë edhe në drejtim të kostos por edhe në drejtim të zgjerimit total të rrugës, pra rrugë +trotuar, duke patur parasysh që aty bëhet fjalë për një zonë të mbrojtur që ka dhe ajo limitet e veta se sa mund të zgjerohemi.

### Znj.Antoneta Çunaj

Për këtë project vendim ësht mbledhur komisioni?

### Z.Flori Lika

Në datën 28 janar është mbledhur komisioni.Dokumentacioni ishte I plotë.U diskutuan edhe këto propozimet që u përmendën këtu nga ana e këshilltarëve por si përfundim u la dakort që project vendimi të kalonte dhe më vonë mund të kishte rishikime

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim pikën 11 të rendit të ditës.

Pro 38 vota

Kundra nuk ka..

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

### Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim: "Për projektimin dhe financimin e segmentit rrugor, nga "Unaza e madhe e Rrugës Skënderbe" deri tek kryqëzimi me rrugën "Mujo Ulginaku", si dhe autorizimin e ekzekutivit të bashkisë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në kuader të realizimit të këtij projekti

# Z.Arnando Çupa

Kryetare, ju kam bërë me dije këshilltarëve në rrugë elektronike që kjo pikë është hequr nga rendi I diës sepse është trajtuar në një mbledhje të mëparëshme të këshillit bashkiak dhe gjithashtu ka patur një vendimmarrje për të.Faleminderit!

### Znj.Antoneta Çunaj

Në rregull atëherë kalojmë në pikën trembëdhjetë të rendit të ditës.

### Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim "Per miratimin e projektit per vazhdimin e fazes II te Unazes se Cakranit"

### Znj.Antoneta Çunaj

Po i japim fjalën përfaqësuesit të bashkisë.Po kryetar.

### Z.Armando Subashi

Ne jemi duke bërë me ndërrmarjen e bashkisë, kemi mbyllur fazën e parë të unazës së Cakranit. Kemi filluar fazën e dytë, kemi arritur deri në një farë vendi në le të themi aty ku është bërë ajo pjesa e pedonales dhe tani ngelet e nevojshme që gjithë ajo unazë të lidhet me pjesën tjetër të rrugës dhe për të vazhduar pastaj drejt lagjeve të sipërme dhe kryesisht drejt fshatrave Vreshtas, Gorishovë por edhe disa lagje të vetë Cakranit.Po të shikoni në ekran, unë kam ngritur një grup pune në fakt, me administratorin e njësisë, nga drejtoria e pronave, me topograf, me arkitekt, dhe kemi parë dy variante të mundshme atje që mund të zgjerohet unaza.Bëhet fjalë për një gjerësi 8 m rrugë + trotuar 2+2=4, pra vete realisht 11-12 m jashtë për jashtë i gjithë projekti. Kemi shkuar në terren, specialistët kanë marrë statusin e pronave. Ka objekte s'ka objekte, ka troje, ka tokë bujqësore etje.dhe në të dyja variantet është përpiluar edhe një tabelë me përparësitë apo mangësitë e secilit variant.Sigurisht që kriteret janë dy dhe biem dakortë të gjithë,/së pari që të jetë me sa më pak prishje dhe realisht prek disa kasolle, gjëra të vogla, pra nuk kemi shtëpi apo objekte të rëndësishme në këtë drejtim që mund të krijojnë probleme apo dhimbje për njerëzit.Së dyti është pjesa e shpronësimit, ku sa më pak shpronësime të ketë sepse t mos harrojmë që shpronësimi i kësaj do të përballohet nga buxheti i bashkisë.Kështu që kemi dy variantet aty në ekran. Aty në tabelë paraqitet varianit 1 dhe 2.. Po të shikoni pak a shumë këto që sapo unë thashë, varianti 1 është si më i përshtatshëm, e para se është edhe më i shkurtër, pra vetë kostoja e rrugës duke qënë më e shkurtër është më e ulët por realisht nuk prishim asnjë banesë, prishim disa kasolle dhe pjesa tjetër është pjesa e shpronësimit të trojeve apo tokës bujqësore që mund të

jetë atje sepse tek disa nga pronat edhe statusi është i pasqaruar akoma.Se bëhet fjalë që kur janë ndarë tokat mund të jenë ndarë me ligjin 7501, sot zona është zhvilluar, janë ndërtuar shtëpi, një pjesë mund të kenë ndryshuar statusin juridik mund të jenë kther në truall etje.Por gjithësesi këto janë gjëra që komisioni që do të ngrihet për shpronësimin i merr të gjitha pronat rast pas rastit dhe duke marrë edhe statusin ligjor dhe nga Kadastra dhe vendos pastaj se me çfarë vlere do të shpronësohet, do të shpronësohet si truall apo si tokë bujqësore, mbi bazën edhe të vendimit përkatës të qeverisë.Kështu kjo është pak a shumë ajo që unë doja të thoja, mgjth këshilli ka vendimmarrjen e vetë.E rëndësishme është që ne sot të përcaktojmë një gjurmë nga të dyja këto variante dhe pastaj ti hapet rruga shpronësimit dhe vazhdimit të punimeve,Sepse në fund të fundit ky është qëllimi që atë punë që kemi nisur ta çojmë derinë fund.

### Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit kryetarë!Le tia japim fjalën përfaqësuesit të komisionit dhe më pas çdo këshilltari që do të dojë të flasi.

### Z.Florian Lika

Edhe ky projekt vendim u diskutua në komision dhe u vendos për të kaluar për miratim në këshill dhe për të zgjedhur njërin prej projekteve.

#### Z.Endri Jaupaj

Në komision kishim mangësi të projekteve, çështje teknike ishte por kjo na pengoi që në komision të zgjidhnim njërin prej projekteve.Mgjth me çfarë kam marrë dhe unë informacion, varianti 1 është më i përshtatshmi.

### Z.Kreshnik Dapi

Edhe për ne varianti 1 duket më ekonomik dhe më i pështatshëm.

#### Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim variantin 1 mqs siç doli këtu është më ekonomik dhe më i përshtatshëm.

#### Z.Ilia Fili

Përpara se ta hedhim në votim, unë kam një sygjerim.Tek materiali që unë disponojë ka vetëm thjeshtë një njoftim dhe nuk jepet qartë qoftë edhe një përshkrim i shkurtër për variantet duke pasqyruar vlerat e secilit variant dhe problematikat që ka secili variant.

### Z.Armando Subashi

Ja ku i keni tabeat e pasqyruara në ekran. A kanë qënë këto tabela kur janë diskutuar projektvendimet në komision?

#### Z.Ilia Fili

Personalisht edhe unë jam mbështetës i variantit 1.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim ? Pro 38 vota Kundra nuk ka.. Abstenim nuk ka. Miratohet.

### Pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e vijimit te procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. 7/362 zk. 8531, lagja "1 Maj" Fier pasurisë nr. 4/14 zk. 8534, pasurinë nr. 4/30-N2 zk. 8534 lagja "Kastriot" Fier, në pronësi të Bashkisë Fier"

### Znj.Antoneta Çunaj

Parapraktisht ja japim fjalën përfaqësuesit të bashkisë.

### Z.Arbion Behari

Është zhvilluar mbledhja e komisionit dhe këto materiale kanë kaluar në komision.Nqs ka pyetje nga këshilltarët unë jam këtu për tju përgjigjur pyetjeve.

### Z.Kreshnik Dapi

Unë si anëtarë i komisionit, komisioni u mblodh dhe mori në shqyrtim pikën 14 të rendit të ditës.Unë personalisht isha kundra në komision dhe prapë jëm kundra.E them përsëri me keqardhje, se edhe Z.Ilia par pak çastesh e përforcoi, që vazhdon terri informativ për këshillin bashkiak.Ja thashë edhe zotërisë, Albionit në komision.Së pari në lidhje me pikën 14, po ashtu dhe me pikat15,16, të rendit të ditës, të paraqitura nga ekzekutivi i bashkisë për miratim.Në gjykimin tim, dhe të tonin, këto pika nuk mund të parashtrohen për miratim në këtë periudhë, e cila është një periudhë parazgjedhore pasi këto pika mund të kenë dhe efekte elektorale.Dhe ne si grup këshilltarësh i PSD-së do ti ankimojmë me procedurat përkatëse.Së dyti që është më e rëndësishme.Këto projekt vendime janë të pashoqëruara me dokumentacionin përkatës ligjor, si certifikatat e pronës, hartat treguese, nuk ka një relacion të gjendjes aktuale të aseteve, të shoqëruara me pamje dhe foto, të hartuara nga grup pune apo specialist të fushës.Dhe së treti në mbledhjen paraardhëse, ne si grup këshilltarësh të PSD-së kemi kërkuar informacion nga ekzekutivi në lidhje me të gjiyha pronat që bashkia ka, qera dhënien e tyre që nga 2015 deri në 2024 dhe situatën aktuale të tyre në lidhje me respektimin e kontratave të lidhura si dhe subjektet që i disponojnë.Erdhi djaloshi, zotëria, Arbioni me shumë kulturë dhe edukatë dhe me një bllok pune me vete, pa asnjë material shpjegues në komision.Unë e kundërshtova dhe i thashë:Nuk ke të paktën certifikatën e tokës.Po më tha do ta dërgojë sekretari në ditët në vijim.Ndërkohë, për atë shoqërinë në fjalë që ka kontratën aktualisht dhe që ne duhet të ngremë dorën që tja rinovojmë, normalisht duhet të vinte një relacion shpjegues edhe për shoqërinë, në çfarë gjendje është shoqëria.Pavarësisht se çdo biznes është i respektuar, por të dinim se në çfarë situate financiare është kjo kompani, si ka qënë marrëdhënia e saj gjatë këtyre viteve me bashkinë?Nëse ka kompani të tjera të interesuara po për të njëjtat prona që ne ofrojmë të ardhurat më të larta dhe kushte më të mira sepse edhe ai VKM nr.54 që i referohemi ne, nuk ka vetëm të ardhurat por ka edhe disa kritere të tjera tek dhënia e pasurive dhe aseteve.Kjo ishte pjesa e debatit në komision dhe arsyetimi i votës sonë kundra.

# Z.Arnando Çupa

Kryetare mund të sqarojë diçka?Në momentin që më është vënë materiali në dispozicion nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Pronave, e kam transmetuar në mënyrë elektronike tek këshilltarët dhe që nga ai moment është disponibël ku janë të gjitha dokumentat përfshirë certifikatat e pronave dhe hartat treguese.Unë nuk jam specialist i fushës që të vërtetoj që dokumentacioni është i plotë ose jo, por unë të gjithë dokumentacionin që më ka vënë në dispozicion Drejtoria e Pronave e kam komunikuar te këshilltarët elektronikisht.Përsa i përket atyre relacioneve , ato duhet të ishin ezauruar në komision dhe e them këtë se shumica e komisioneve janë mbledhur në zyrën e këshillit dhe unë jam në dijeni që komisioni përkatës është mbledhur dhe ka patur një vendim marrje për ta kaluar në këshill

# Z.Endri Jaupaj

Zoti sekretarë, kam një pyetje.Në momenti që hedh materialet, i merr ato materialet dhe , ai që është i përgjegjshëm dhe kërkon të vijë i pregatitur, e ka të pamundur të orjentohet me mënyrën se si ti i dërgon ato materiale.I ke dërguar radhë materialet nga pika 1 e deri në pikën X, dhe pastaj fillon dhe hedh pikat shtesë, dhe këto pikat shtesë vazhdojnë deri një orë përpara mbledhjes.Të lutem, kjo nuk duhet të vazhdojë më kështu sepse ne e kmi të pamundur të orjentohemi dhe kjo vlen për të gjithë këshilltarët, mendojë unë.

# Z.Arnando Çupa

Z.Endri Jaupaj, në cilësinë e sekretarit të këshillit bashkiak jua kam thënë dhe herë të tjera që mua të gjithë materialet në momentin që më vijnë, unë jam i etyruar ti përcjellë edhe ato materialet shtesë që ju i përmendët.Renditja është e tillë sepse mua në atë rend më vijnë materialet.

Z.Endri Jaupaj

Si ti lidhim ne ato?

# Z.Arnando Çupa

Unë ikam specifikuar materialet që dërkojë duke thënë psh. Material shtesë për pikën 13 etje.

# Z.Endri Jaupaj

Atëherë, duke u bazuar në rregullore. Materialet merren nga këshilltarët 5 ditë përpar ditës së mbledhjes, ndëkohë që ti vazhdon dhe dërgon materiale deri një orë përpara mbledhjes, atëherë si do të pregatitemi ne?

# Z.Arnando Çupa

Në momentin që më vijnë unë jam i detyruar pë shkak të detyrës që kam tju dërgoj,Për pjesjën e futjes së materialeve dhe pikave shtesë, u votua në fillim, ju po të ishit kundra nuk i bënit pjesë të rendit të ditës.Unë me cilësinë e sekretarit të këshillit në momentin që më vijnë materiale, ta

përcjell elektronikisht tek ju.Ju e keni vendimmarrjen, dhe unë jua kam thënë dhe në raste të tjera jo vetëm juve por të gjithë këshilltarëve, ju keni vendimmarrje të plotë që nqs nuk e konsideroni të arsyeshme që ai material të futet në rendin e ditës sepse nuk ka ardhur brenda afatit ligjor, në këtë rast e rrëzoni me votë.Faleminderit!

### Z.Endri Jaupaj

Ti je pika lidhëse e ekzekutivit me këshillin, je ti ai që duhet ti bësh materialet gati, e ti tagrin e plotë për tu marrë me këtë punë.

### Z.Arnando Çupa

E keni gabim. Materialet i pregatit administrata, unë në cilësinë e sekretarit të këshillit jua transpetoj ato tek ju.Ju e dini shumë mirë që pjesa e paraqitjes së materialeve nga ana e administratës jashtë afatev ligjore është diskutuar disa herë në kryesi.Mos më kërkoni që unë të dal jashtë kompetencave të mia.

Znj.Antoneta Çunaj

Po znj.Sema

Znj.Evisa Sema

Do të vazhdojë në vijimësi të fjalës që tha sekretari.E para.U ngrit problemi i komisioneve.E rëndësishme është vërtet që të mblidhen komisionet por jo çdo gjë vendoset në komisione.Një projekt vendim i cili nuk miratohet në komisione, ngrihet problemi këtu që nuk duhet të kalojë apo duhet të kalojë. Po ne të tjerët pse jemi këtu, ne që nuk jemi pjesë e komisioneve?Gjëja kryesore është që, dakort u mblodh komisioni,trajtoi të gjitha problematikat që janë ngritur, atëherë vjen pika në rendin e ditës në këshill dhe tani shtrojnë pyetjen të gjithë:Për pikën në rendin e ditës, pretendojnë që është krijuar një lëmsh para porte në mënyrën se si dërgohen materialet, atëherë çdo këshilltarë ta shthuri lëmshin dhe të vijë këtu, pse kështë këshilltarë , prandaj ka marrë përgjegjësitë, 24 orë para mbledhjes së këshillit, mos të fleri gjumë, të lexojë materialet e këshillit, pastaj të ngrejë pyetje për të gjitha paqartësitë.Çfarëdo lloj pyetje që keni drejtojani administratës, mos ja drejtoni sekretarit të këshillit, është administrata që i pregatit materialet.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do tjetër fjalën?Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

I gjithë debati që po bëhet ka një arsyetim, sepse tek materiali që disponojmë ne bëhet fjalë për dhënien me qera të numrave, sepse ne nuk e kemi të qartë se çfarë përfaqëson ky numër, sepse në material është pasqyruar numri kaq dhe aq dhe ne nuk e kemi të qartë nëse është sallë, është apartament, është shesh etje? Kjo është mangësia. Sekretari tha që janë hedhur elekrtonikisht sqarimet e nevojshme. Në vazhdim të sqarimeve që bëri sekretari i këshillit unë i drejtohem kryetarit: Zoti kryetarë. Na keni premtuar që do të na paisni me tabletë. Keni 3 mbledhje rrjeshtë që na i keni premtuar dhe nuk e bërë. Tani mqs erdhën ca fonde nga këto të trashëguara kaloini ca për këtë/problem, Pra për paisje që të lexohen materialet, sepse për mua psh është e vështirë që të lexojë

materialet në telefon, kjo ishte e para.E dyta.Kryetarja e këshillit ka një të metë, cila është e meta?Mbase për ne këtu në sallë ka qënë një problem që është diskutuar shpejtë, sepse mua psh më njohin si Ilia dhe si inxhinier, ndërsa unë një pjesë të kolegëve këtu nuk i njoh në kuptimin e formimit profesional.Ne duhet të kishim bërë këtu një prezantim që të njiheshim me njëri-tjetrin.Mqs zoti kryetarë na premtoi që për vitin e ri do të na shtronte një drekë të gjithëve sëbashku e cila nuk e di se për cilat arsye nuk u realizua.

#### Z.Armando Subashi

Nuk e keni nga unë mosmbledhjen, por ju u bëtë 10 veta, prandaj nuk u bë.

#### Z.Ilia Fili

Kjo mbledhje do të shërbente për tu njohur dhe për tu prezantuar mëmirë me njëri tjetrin, për të ditur më konkretisht psh sa ekonomist ka grupi i partisë socialiste, sa juristë, sa inxhinier ka.

### Znj.Antoneta Çunaj

Të gjitha këto informacione që ju kërkoni mund tju jepen mbas mbledhjes përmes sekretariatit të këshillit, Tani e hedhim në votim.

Pro 34 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

### Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqe "tokë pa frut", ndodhur në fshatin Hasturkas Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier."

### Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni përkëtë projekt vendim?

Z.Kreshnik Dapi

Unë e thashë në diskutimin e mëparshëm u trajtuan të treja pikat 14,15,16 sepse kanë të njëjtën përmbajtje.

#### Znj.Antoneta Çunaj

Atëherë e hedhim në votim

#### Z.Elvi Daka

Parase ta hedhim në votim, ka diçka për të thënë.Duke qënë se jam i zgjedhur nga kjo zonë dhe duke qënë se është një zonë e mbingarkuar në sipërfaqen e saj nga panelet fotovoltaike, dhe besoj se një sipërfaqe e tillë mjaft e madhe do të shfrytëzohet për këtë qëllim, unë do të kërkoja nga bashkja nëse është mundësia që të gjithë këta operatorë që do të kryejnë investime në këtë territor,

të kalonin një pjesë të buxhetit të tyre për shpenzime, përpirësimin e kushteve të këtij komuniteti brenda të cilit do të vendosen këto panele.distanca nga fshati Hasturkas është goxha e afërt me vendin ku do të vendosen panelet, nuk e di por flasim për një sipërfaqe rreth 300 hektarë tokë dhe minimalishi këto subjekte që do të investojnë.

### Z.Armando Subashi

Nuk po flasim për sipërfaqen totale në të cilën janë vendosur panelet në atë zonë.Në rastin konkretë bëhet fjalë për një sipërfaqe rreth 6 dynym.Shumë dakort jam por tua sqaroj edhe njëherë se mbase nuk keni qënë të vëmendshëm në sqarimin që bëra mbledhjen e kaluar.Herën e fundit kur miratuam paketën fiskale, për herë të parë për këtë vit vumë një tarifë nqs e mbani mend, x lekë për 1 megavat, ishte këshilli që e vuri dhe të gjitha ato kompani që po investojnë apo që kanë investuar në panele, do të paguajnë në bashki një tarifë ekstra.Do ta mbledhim këtë vit. Sepse ky është viti i parë që e kemi vendosur, dhe në mos gabojë e vumë 500 mijë lekë për 1 megavat.E gjithë ajo shumë që do të mblidhet do të shkojë në ndihmë të investimeve në ato zona, plus që jua kam thënë edhe në një mbledhje këshilli që këto kompani kanë kërkuar pra sipas planit të investimeve dhe kontratën që kanë me qeverinë, kanë kërkuar 4 fshatra në të cilat kalon linja , kanë kërkuar që ne ti çojmë një projekt në infrastrukturë ku secili është deri në 100 mijë euro.Pra edhe këtu është një investim që Voltitalia do ta bëjë gjatë këtij viti.Dhe ne në bashkëbisedim edhe me kryepleqtë e fshatrave, dhe me administratorët e njësive. Edhe me faktorë atje, kemi identifikuar edhe për Hamilin edhe për Ndërmënasin edhe për 2 fshatrat e tjera problematikat përkatëse dhe jua kemi dërguar atyre.Procedurat e tjera ata do ti vazhdojnë dhe do të vazhdojnë me investimet.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit zoti kryetarë.E hedhim në votim

Pro 34 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

### Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim"Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë nr. 9/10 zk. 3358 e llojit toke arë, ndodhur në fshatin Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, pasurisë nr. 4978 zk. 1273 e llojit toke arë, ndodhur në fshatin "Peshtan Bregas", Njësia Administrative Frakull Bashkia Fier.

### Znj.Antoneta Çunaj

Mqs edhe kjo pikë ka të njëjin tematikë dhe është trajtuar në komision sikurse u tha nga përfaqësuesi i komisionit, dhe mqs nuk ka pyetje dhe diskutime pasi ato u ezauruan në pikat e mësipërme, atëhërë e hedhim në votim pikën 16-të të rendit të ditë . Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra 3 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

#### Pika e shtaëmbëdhjetë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Nuri Ferko, lagjia "Mbrostar Ferko", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 23.11.2024.

Znj.Antoneta Çunaj

Mqs bëhet hjalë për një person të cilit i është djegur shtëpia nga zjalli, dhe mqs nuk ka pyetje dhe diskutime nga këshilltarët pasi kjo pikë është trajtuar edhe në komision e hedhim direkt në votim

Pro 38 vota

Kundra nuk ka .

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

### Pika e tetëmbëdhjetë e rendit të ditës

Kërkesë për dhënie ndihme të menjëherëshme financiare të shtetasit Alketi Zonja

Znj.Diana Joti

Përshëndetje!Kërkoj vëmendjen dhe ndihmën tuaj, kolegëve që janë këtu, për rastin e Alketi Zonjës.Është 48 vjeç, trajtohet me pension verbërie të plotë, grupi i parë me kujdestari nga bashkëshortja e tij Lindita Zonja.Ka 2 vajza të vogëla në moshën 7 dhe 9 vjeçe të cilat ndjekin arsimin 9-vjeçarë.Zoti Alketi Zonja është trajtuar me ndihmë ekonomike por i është ndërprerë me motivacionin që nuk ka marrë pikët në sistem.Familja në këto kushte e ka tepër të vështirë për të përballuar jetesën, gjendjen ekonomike dhe jetesën e përditësme, shkollimin e vajzave dhe paesën e kredisë. Për ti ardhur në ndihmë kësaj familje , kërkoj dhe propozoj, që nga ana e këshillit bashkiak ti miratohet një ndihmë financiare me vlerën e 50 mijë lekëve.

Znj.Yllka Sheshi

Më falni po kjo gjë është anormale.Si mundt ti ndërpritet ndihma ekonomike kësaj familje në këto kushte dhe të skualifikohet për msplotësimin e pikëve nga sistemi.Mirë ky rast u identifikua dhe erdhi përmes kësaj kërkese në këshillin e bashkisë, po sa familje të tjera mund të jenë si puna e kësaj familje?

### Znj.Antoneta Çunaj

Përsa i përket kësaj që thoni ju, për skualifikin në sistem nuk e ka në dorë as bashkia e as këshilli bashkiak, janë institucione të tjera ato që e përcaktojnë këtë gjë. Ne po flasim për këtë rast.

Z.Kreshnik Dapi

1

Është e mundur që tia rrisim pak këtë vlerë?

### Z.Armando Subashi

Kjo vlerë është për gjithë vitin, apo e merr në mënyrë të menjëhershëm?Lee ti rritet vlera në 100 mijë të reja.

Z.Elvi Daka

Edhe komisioni i Mirëqënies Sociale kishte të njëtin propozim, për ta rritur vlerën në 100 mijë lekë të reja.

# Znj.Antoneta Çunaj

Mqs edhe nga ana e adminisrtatës përmes kryetarit të bashkisë edhe nga ana e komisionit, ehe nga ana e këshilltarit Z.Kreshnik Dapi, u propozua rritja e vlerës në 100 mijë lekë të rela, e hedhim në votim.Kush është dakort?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka .

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Z.Ilia Fili

Kryetare, përpara se të kaloni në pikat shtesë, mqs jemi tek ndimat dhe mqs në fillim të mbledhjes pranuam të fusnin edhe dy ndihma të menjëherëshme financiare, për gazetarin Gledian Hoxhallari dhe për të miturin Noel Curra, unë mendojë që ti trajtojmë tani dhe më pas të kalojmë me pikat e tjera shtes të rendit të ditës.

# Znj.Antoneta Çunaj

Në rregull. Jam dakort me propozimin e inxhinierit.Vazhdojmë me miratimin e ndihmës së menjëherëshme financiare për gazetarin Gledian Hoxhallari me vlerë 200 mijë lekë të reja.Kush është pro?

Z.Ilia Fili

Pa kaluar në miratim dua të di sa ne lejohet ndihma?

Z.Armando Subashi

Nuk e bëjmë dot më shumë.Deri në 200 mijë na lejohet.

Znj.Antoneta Çunaj

Le ta hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Znj.Antoneta Çunaj

Kalojmë tek ndihma e menjëherëshme financiare për fëmijën 13 vjeçar Noel Curri, në vlerën 200 mijë lekë.Kush është dakort?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka .

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

#### Pikat e parë shtesë të rendit të ditës

Projekt vendim "Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese nga projekti për strehimin social"

Znj.Antoneta Çunaj

#### Po kryetarë.

Z.Armando Subashi

Kjo është thjeshtë një projekt ide që ne jemi duke e përfunduar në bashki dhe do ta aplikojmë tek ministria përkatëse pasi është hapur një thirrje në projekte në infrastrukturë, në riparim banesash, në ndërtim banesash etje kryesisht për kategorinë e lagjeve rome, pra atje ku ka komunitet rom.Ne kemi bërë një takim me përfaqësuesit e tyre dhe kemi rënë dakort që ne si bashki do të aplikojmë do të paraqesim në ministri dy projekte, një për KUZ-në e fshtatit Baltës dhe një për KUZ-në e fshatit Drizë, Pra janë dy fshatra ku ka komunitet rom. Sigurisht në këtë fazë që është do të paraqesim thjeshtë projekt idenë. Një nga gjërat që kërkohen aty është edhe nr. i familjeve përfituese nga këto rojekte që do të çojmë, kërkohet edhe një miratim në parim nga këshilli bashkiak sepse janë si kushte të domozdoshme që pastaj projekti të shpallet fitues ose jo, gjë të cilën ende nuk e dimë sot por sigurisht ne do i plotësojmë të gjitha ato të dhëna që kërkon aplikimi atje dhe shpresoj që të shpallemi fitues dhe me fondet e ministrisë dhe padyshim duke u futur edhe ne me bashkëfinancim deri në vlerën e 30%, sepse kështu ishte përcaktuar në shpalljen që ishte bërë, të bëjmë një bashkëfinancim dhe nëse e fitojmë këtë projekt të bëjmë të mundur realizimin e investimit në të dy këto lagje. Fondi është i dedikuar posaçërisht për lagjet me komunitet Rom.Nuk kemi ende projekt zbatimi, jemi thjeshtë në projekt ide në parim.Edhe atje projekt ide do të paraqesim dhe nëse shpallemi fitues pastaj do të detajojmë projektin e plotë dhe pastaj do të shkojmë drejt zbatimit të tij.Kjo është ideja.Kryetare, të lutem mqs kam fjalën kemi edhe pikën tjetër këtu miratimin e venddodhjes të projektit "Dua të luaj". Edhe këtu dua tju infirmoj që jo më larg se 3-4 ditësh dhe kjo është arsyeja që ne nuk e futem me procedurë normale në rendin e ditës por menduam që ta fusim sot sepse po të mos e futnim sot i binte ta

fusnim në mbledhjen e fund shkurtit.Ne na ka ardhur një email nga FSHZH.Ata kanë një buxhet, dhe në disa qytete kryesore janë duke zbatuar një projekt, e kanë titulluar"Dua të luaj".Bëhet fjalë për një kompleks sportiv ku do të ndërtohen fusha ose minifusha basketbolli, futbolli, tendi ndoshta, hendbolli etje dhe një pjesë e saj do të jenë lodra për fëmijë për moshat më të vogla.Na kanë kërkuar në email që tu vëmë në dispozicion një sipërfaqe prej 10 mijë m<sup>2</sup> pra rreth 1 hektarë tokë.Për hirë të së vërtetës, me gjithë kërkimet që bëmë me drejtorinë e pronave të të gjitha pronave që kishim ne në iinvetarë, nuk ishte e mundur për tokë shtetë, sepse e dimë shumë mirë se çfarë ka ndodhur gjithë këto vite, ku janë kther pa fund prona me vendim komisionesh dhe as që bëhet fjalë më për të tilla sipërfaqe.Shumë shumë mund të kishte ndonjë shesh pallati etje. Por ky koncept i këtij projekti nuk është i tillë. Për këtë duhet një terren më i hapur, më i madh, të ketë akses pothuajse nga pjesa dërrmuese e qytetit sepse atje mendohet që të shkojnë të rinj, fëmijë, prindër, gjyshër etje, pra të jetë një kënd i madh sportiv dhe argëtues. Në kushtet që nuk kemi një pronë shtet gjykuam që të shikojmë mundësinë e një prone private. Kemi bërë edhe disa biseda edhe me FSHZH-në dhe me Ministrinë e linjës, të cilat deri diku, jo me shkresa zyrtare deri duku kanë marrë përsipër që të përballojnë edhe fondet që mund të duhen për shpronësimin, sepse realisht 10 mijë m<sup>2</sup> nqs do të ishte truall shkon afërsisht 1.2-1.3 milon euro me 12500 të reja që është çmimi i truallit në Fier sipas çmimit të referencës për m<sup>2</sup>.Ndërsa toka bujqësore, kuptohet, është shumë herë më pak.Por pavarësisht kësaj, e rëndësishme është që ne të përcaktojmë një vend të mirë, një vend të përshtatshëm që sigurisht të ketë akses të bollshëm .Ne kemi paraqitur 3 varjente të mundshme, gjithmonë dike patur parasysh edhe aksesin, pra kuptohet që nuk mund të jetë jashtë qytetit sepse po ishte jashtë qytetit e humbim aksesin që thashë për të lëvizur në këmbë për të gjithë grupmoshat, por duhet të jetë edhe buzë akseve kryesore, buzë rrugëve sepse të paktën nga ato që janë realizuar, në Berat të cilin e kam parë vetë dhe në mos gaboj dhe në Durrës.Projekti është goxha i bukur dhe i realizuar dhe përbënë vlerë të shtuar dhe për qytetin .Nuk është cështja thjeshtë nga pikëpamja funksionale por edhe nga pikëpamja urbane arkitettonike etje dhe krijojnë edhe një pol të rëndësishëm për qytetin. Duke gënë dhe me ndriçim edhe në orë të mbrëmjes, mund të ketë një ambjent i cili do të ketë gjallëri. Pra është mirë që të jetë një ambjet i dukshëm dhe jo i fshehtë. Dhe në fakt ne kemi paraqitur 3 variante aty në ekran po të keni ndonjë pyetje jam i kapur që ti diskutojmë, dhe sot le të marrim një vendim se cilin nga këto variante mund të përzgjedhim dhe tia vëmë në dispozicion pastaj edhe FSHZH-së për të bërë projektimin konkretë por edhe për të filluar ne si ekzekutiv procedurat e shpronësimit. Të treja variantet janë me shpronësim, se bëhet fjalë për pronë private, nuk bëhet fjalë për pronë shtetërore sepse po të kishim pronë shtetërore problemi ishte i zgjidhur.

Znj.Antoneta Çunaj

Të hedhin në votim njëherë pikën e parë shtesë.

1

Pro 35 vota

Kundra nuk ka

Abstenim 2 vota

Miratohet

# Pika e dytë shtesë e rendit të ditës

Projek vendim "Për miratimin e vendndodhjes së projektit "Dua të luaj"

### Znj.Antoneta Çunaj

Mqs për këtë projekt vendim janë paraqitur 3 variante për vendosjen e këtij projekti, kush ka ndonjë mendim për këto variante të paraqitura?

### Z.Agron Profka

Ku ndodhen këto variantet e propozuara?

### Z.Arbion Behari

Varianti i parë ndodhet prapa ETC-së, varianti i dytë ndodhet në lagjen Afrim i Ri, dhe varianti i tretë ndodhet rrugës për tek spitali Memorial.

### Znj.Antoneta Çunaj

Nga të treja variantet e paraqitura , mua më afër dhe më i aksesueshëm më duket varianti i parë mbrapa ETC-së sepse është afër, ka parkime. Kemi afër edhe pallatin e lojërave me dorë dhe bëhet një kompleks shumë atraktiv për të gjitha moshat.

### Z.Agron Profka

Mua dhe varianti i pozicionit afër spitalit Memorial nuk më duket keq sepse dhe ajo zonë po merr një zhvillim të ri.

# Z.Armando Subashi

Tju bëj një shpjegim, ju lutem. Varianti i ETC-së, atje janë realisht 3 fusha është edhe objekti i pallatit të lojërave me dorë, por ai nuk është i hapur përgjithësisht, ai është për ekipet sportive që ka Apolonia, duke filluar nga moshat dhe deri tek ekipi zyrtarë i basketbollit, i volejbollit me të cilët ne marrim pjesë nëpër kampionate. Këtu bëhet fjalë për një ambjent të hapur, pra këtu çdo njëri mund të aksesoj lirshëm.

### Znj.Brunilda Hoxha

Për juve kryetarë cili është varianti më i përshtatshëm? Na jepni një mendim.

# Z.Armando Subashi

Që të flasim realisht dhe hapur fare, ky varianti i ETC-së duke qënë se do të ketë shpronësime sikurse jua thashë, ky në derjtim të shpronësimeve është më i kushtueshmi për hirë të së vërtetës, por në kushtet që këtë shpronësim nuk do ta paguajmë ne si bashki, shpronësimin e merr përsipër qeveria ose FSHZH, kjo për ne del në plan të dytë, ndërsa si akses tek ETC-ja është mjaft mirë sepse ne krijojmë një pol mjaft të mirë aty dhe mund të aksesohet në këmbë lirshëm nga të gjithë.

### Z.Arben Çuko

Mqs janë të tre variantet do të doja që, jo se nuk është mirë tek ETC-ja, tek ETC-ja shtë shumë mirë, por do të doja që të kishte pak shpërndarje mqs atje e kemi tashmë pallatin e lojërave me dorë, ndoshta do të ishte më mirë dhe me kosto më të ulët për shpronësimet që të zgjidhej varianti i vendosjes në rrugën e spitalit Memorial.Do të shtoja edhe një diçka tjetër kryetarë.Do të ishte mirë që këtu, tek ky vend sportiv të parashikohej edhe ndërtimi i ndonjë fushe tenisi sepse po i privojmë të rinjtë e të rejat që kanë prirje në këtë fushë.

### Z.Armando Subashi

Të bëjë dhe një shtesë tjetër. Të dy variantet e tjera, përgjithësisht janë mbi tokë bujqësore. Tani, unë besoj që ju e dini që ka një ligj për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe që të shpronësosh tokë bujqësore dhe të ndërtosh pastaj aktivitete apo investime me karakter jo bujqësor, siç është edhe ky, padyshim që do disa procedura më të ndërlikuara sepse e para ajo tokë bujqësore duhet hequr nga fondi i tokave bujqësore, kërkon miratim nga Qarku, nga Ministia e Bujqësisë dhe ndoshta në këto përmasa që është investimi, mund të kërkojë edhe VKM

### Znj.Antoneta Çunaj

Për të gjitha këto arsye që shpjegoi kryetari, unë jam e mendimit që të votojmë variantin e parë atë tek ETC-ja.Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

#### Pika e tretë shtesë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 130 datë 26.11.2024 "Për miratimin e financimit të shpenzimeve të transportit të nxënësve që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër në një largësi mbi 2km larg institucioneve arsimore publike më të afërta"

Znj.Antoneta Çunaj

Këtë e kemi diskutuar në një mbledhje të mëparshme është një shtesë e asaj që kemi diskutuar, këto janë tarifa të përcaktuara me VKM, Kush është pro?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e katërt shtesë e rendit të ditës

Projekt vendim\_"Për miratimin e përfundimit të proçedurave të privatizimit të banesës e cila ka mbetur pa u regjistuar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratës para noterit"

Znj.Antoneta Çunaj

Materialin e keni, ju ka ardhur.

Z.Armando Subashi

Për cilin shtetas bëhet fjalë? Ka qënë kontrata e privatizimit të këtij shtetasi por ka qënë e panoterizuar

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është marrë me këtë material?

Z.Arnando Çupa

Më falni. Drejtoresha juridike ju kërkon ndjesë pasi e ka patur të pamundur pjesëmarrjen në këtë mbledhje për shkakë se është e sëmurë. Me sa kam arritur të kuptoj është ao që tha kryetari , kontrata e privatizimit me bashkinë është por është e pa nënshkruar para noterit. Pra është përmbyllur e gjithë procedura e privatizimit dhe ka mbetur vetëm lidhja e kontratës para noterit. Dokumentacioni përkatës është I pasqyruar dhe aktmarrëveshja përkatëse.

Znj.Antoneta Çunaj

Konkretisht për cilin person bëhet fjalë?Se në project vendimin që unë kam nuk ka emër.

Z.Arnando Çupa

Kryetare, emrin e keni të specifikuar tek relacioni.

Znj.Antoneta Çunaj

Emri i personit në bazë të relacionit është Flamur Feçorr Ferko.Kush ëhtë pro?

Pro 38 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

ZnjAntoneta Çunaj

Faleminderit të gjithë këshilltarëve të pranishëm!

Ky proces verbal ka 29 (mjëzet e nëntë) faqe, mbahet në tre kopje nga Sekretari i Këshillit Z. Arnando Çupa

Sekretari i Këshillit

Arnando CUPA

